



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë-Ministarstvo Pravde-Ministry of Justice
Shërbimi Korrektues i Kosovës/Korrektivna Sluzba Kosova/Kosovo Correctional Service
Drejtoria e Përgjithshme Prishtinë

Shërbimi Korrektues i Kosovës

Rregullë e brendshme

Tretmanet për të Burgosurit

Në mbështetje të neninit 12 paragrafi 1 nënparagrafi 1.10 të Ligjit nr.08/L-131 Për Shërbimin Korrektues të Kosovës, Drejtorit i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës, nxjerrë:

Rregullë e brendshme Tretmanet për të Dënuarit

Neni 1

Qëllimi

Kjo rregullë e brendshme ka për qëllim të sqarojë procedurat e klasifikimit dhe vendosjes së personave të dënuar në Institucionet Korrektuese në bazë të tretmanit.

Neni 2

Misioni i Shërbimit Korrektues i Kosovës

Shërbimi Korrektues i Kosovës në bashkëpunim me të gjithë partnerët e drejtësisë penale dhe në përshtatshmëri të vazhdueshme me ligjet e aplikueshme në Kosovë synon të korrektoj dhe ri socializoj të dënuarit, duke respektuar të drejtat e tyre fundamentale pa marrë parasysh racën, gjuhën, religjionin si dhe të sigurojë ambient të sigurt për stafin, të dënuarit dhe shoqërinë.

Neni 3

Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë këto kuptime:

1.1 **Tretman** - nënkupton organizimin e jetës së përditshme të të dënuarve duke përfshirë aktivitete që synojnë arsimimin, trajnimin profesional, punësimin për zhvillim personal dhe social të dënuarit si dhe përgatitja e tij për lirim;

1.2 **I dënuar** - nënkupton personin i cili është dënuar me aktgjykim të formës së prerë nga gjykata kompetente;

1.3 **I burgosuri** – nënkupton personat e paraburgosur dhe të dënuar.

1.4 **IK** - nënkupton Institucionin Korrektues;

1.5 **Ekipi multiprofesional** - nënkupton ekipin multiprofesional të Institucionit Korrektues që përbëhet nga profesionist të fushave të ndryshme të angazhuar në rehabilitimin dhe risocializimin e personave të dënuar;

1.6 **Ekipi profesional i pavijonit** - nënkupton ekipin multiprofesional të pavijonit në Institucionin Korrektues që përbëhet nga profesionist të fushave të ndryshme të angazhuar brenda pavijonit;

1.7 **KKB** –nënkupton komisionin për klasifikimin e rrezikshmërisë së të dënuarve.

Neni 4

Vendosja e personave të dënuar në Institucionet Korrektuese

1. Gjatë vendosjes së personit të dënuar në Institucionin Korrektues ose në njësi të veçantë të Institucionit Korrektues duhet të merren parasysh: planifikimi i dënimit, mosha e tij, llojet dhe pesha e dënimit, dënimet e mëparshme (nëse ka pasur), shëndeti fizik dhe mendor, rekomandimet prej autoriteteve relevante për trajtim të veçantë, lokacioni i vendqëndrimit apo vendbanimit të familjes së tij, siguria si dhe arsyet lidhur me arsimimin ose punën që mund të jenë të rëndësishme për ri integrimin e tij shoqëror.
2. Gjatë vendosjes duhet të merret parasysh mundësia për zbatimin e programeve të përbashkëta riedukuese si dhe nevoja për shmangien e ndikimeve negative.
3. Përsosnat e dënuar meshkuj dhe femra vendosen ndarazi. Gratë shtatëzëna dhe nënat me fëmijët e tyre vendosen ndarazi nga gratë e tjera të dënuara, të miturit vendosen ndaras nga personat madhor në Institucionin Korrektues për të mitur.
4. Personat e dënuar vendosen ndaras në Institucionin Korrektues nga personat e paraburgosur.
5. Duhet bërë përpjekje që përsosnat e dënuar për herë të parë të ndahen nga personat të cilët më parë kanë mbajtur dënimin me burgim (recidivistët).
6. Të dënuarve me çrregullime të shëndetit mendor apo atyre në varësi nga droga dhe alkooli duhet t'u ofrohet përkujdesje apo trajtim i veçantë në IK sipas rekomandimit/apo vendimit të organit kompetent, të dënuarit me çrregullime të shëndetit mendor parimisht vendosen dhe trajtohen si të gjithë të dënuarit tjerë, përjashtimisht ata mund të vendosen në njësi apo institucione të veçanta për trajtim më adekuat shëndëtesor dhe menaxhim më të lehtë.
7. Të dënuarit të cilët transferohen nga një IK në institucionin tjetër, fillimisht vendosen në tretmanin e pranimit dhe brenda periudhës deri shtatë (7) ditë duhet të bëhet vlerësim nga zyrtari përgjegjës për trajtimin e të burgosurve dhe vendoset në tretmanin paraprak ose tretman tjetër sipas vlerësimit.

Neni 5

Planifikimi i dënimit – Plani individual

1. Planifikimi i dënimit është bazë për klasifikimin e të dënuarve në tretmane përkatëse.

2. Njësia përkatëse për vlerësim e bën planifikimin e dënimit për secilin të dënuar sipas procedurave përkatëse për planifikim të dënimit i cili do të zbatohet në IK.
3. Planifikimit i dënimit duhet të bëhet sipas dispozitave të UA për funksionimin e NJVKB.
4. Progresi lidhur me planifikimin e dënimit vlerësohet të paktën dy (2) herë në vit nga IK.
5. IK mund të kërkojnë nga Njësia për Vlerësim dhe Klasifikim të bëjë rivlerësimin e planit individual për shkak të nevojave të dënuarit dhe rrethanave tjera të reja të krijuara.

Neni 6

Qëllimi i Tretmaneve

1. Qëllimi i tretmaneve është që të dënuarit të motivohen për sjellje të mira dhe të stimulohen që të jenë pjesë e zbatimit të planifikimit të dënimit dhe procesit të risocializimit.
2. Çdo nivel i tretmanit duhet të ofrojë programe adekuate që mundëson aktivitete të ndryshme të cilat ndikojnë pozitivisht në përgaditjen e tyre për jetë në liri.
3. Llojet e tretmanëve të parapara me këtë rregull duhet të zbatohen për të gjithë të dënuarit madhor si për meshkuj ashtu edhe për femra, të cilët janë dënuar me burgim dhe burgim të përjetshëm.
4. Të paraburgosurit vendosen në tretmanin themelor apo standart sipas vlerësimit deri sa aktgjykimi të bëhet i plotfuqishëm.
5. Të paraburgosurit të cilët ende nuk kanë dënim të plotfuqishëm me aprovim të gjyqtarit të Gjykatës Kompetente mund të vendosen në IK dhe të kalojnë nga tretmani themelor në tretmanin standart.

Neni 7

Tretmanet

1. Secili tretman ofron një varg privilegjesh dhe stimulimesh të ndryshme që rriten me avancimin e të dënuarit. Zakonisht të dënuarit në tretmanin themelor do të marrin minimumin e garantuar me ligj të të drejtave që ju takojnë.
2. Të dënuarit në tretmanin standart dhe të avancuar do të marrin progresivisht më shumë privilegje edhe pse saktësisht natyra e secilit privilegj do të varet sipas aktiviteteve dhe programeve të disponueshme në secilin IK.
3. Pa marrë parasysh tretmanin në të cilin është vendosur i dënuari, atij do t'i jepet mundësia të participojë në aktivitetet e IK për ngritjen e ndjenjës së përgjegjësisë dhe vetëbesimit.
4. Metodat për inkurajim të bashkëpunimit dhe pjesëmarrjes së të dënuarve në tretmane zhvillohen nga zyrtarë profesional.

5. Mbajtja e të dënuarit në cilin do nivel të tretmanit por edhe ngritja apo ulja (degradimi) i tij varet nga sjellja dhe performanca e të dënuarit.

6. Me sjellje dhe performancë të mirë do të vlerësohet si:

6.1 Progresi në lidhje me planifikimin e dënimit;

6.2 Higjiena personale, paraqitja dhe veshja e përshtatshme;

6.3 Respektimi i rregullave të institucionit;

6.4 Përpjekjet dhe arritjet në punë dhe aktivitete tjera konstruktive si p.sh: pjesëmarrje e rregullt në planifikim dënimi, aplikim dhe arritjet në edukim (duke përfshirë edhe trajnimet/kurset profesionale), qëndrim konstruktiv dhe dëshirë për të përfituar nga programet kryesore për trajtim, si p.sh: të kontaktojë me stafin e programeve, të kuptojë rëndësinë e programeve dhe t'i shfrytëzojë mundësitë që japin programet për nevojat e veta;

6.5 Ti përkrahë përpjekjet e të dënuarve tjerë që të angazhohen në planifikimin e tyre të dënimit, që të adresojnë sjelljen e tyre kundërligjore e të bëjnë një jetë më konstruktive;

6.6 Sjellje dhe gjuhë jo e dhunshme apo kërcënuese, detyrim, shfrytëzim apo frikësim;

6.7 Respektimi pa diskriminim i secilit person pavarësisht racës, religjionit, rrethanave personale etj;

6.8 Respekt i ndërsjellët, p.sh: bashkëpunim me stafin gjatë kryerjes së detyrave të veta, pajtohet me pritjet e arsyeshme të stafit, pa tentime për ta gënjyer apo manipuluar stafin dhe të dënuarit e tjerë;

6.9 Sjellje korrekte ndaj të tjerëve, p.sh: dëshira për të ndërtuar raporte të mira me të dënuarit e tjerë dhe ofrimi i përkrahjes për ta dhe jo ndërhyrje në pronën e huaj;

6.10 Qëndrimi larg nga gjërat e ndaluara p.sh. alkooli, droga apo çdo lloj kontrabande;

6.11 Shprehja e mendimeve, kërkesave, ankesave apo pakënaqësive në mënyrë të arsyeshme dhe konstruktive;

6.12 Në respekt ndaj shëndetit dhe sigurisë së të tjerëve, p.sh; pastërtia dhe rregulli i dhomave dhe hapësirave të tjera, përdorimi i duhur i pajisjeve, materialeve dhe makinave të ndryshme, silltet në pajtim me procedurat e sigurisë ndaj zjarrit, përfshirë edhe rregullat për pirje të duhanit;

6.13 Të mos përfshihet në Shitblerje apo shkëmbim të gjësendeve mes të dënuarve, i dënuari gjësendet personale mund t'ja dhuroj një të dënuari tjetër pas aprovimit të kërkesës nga Drejtori i Institucionit.

7. Me rastin e transferit (vullnetar) të të dënuarve nga një institucion në tjetrin i dënuari do të vendoset po në atë tretman që ka caktuar IK dërgues por së pari duhet të vendoset në tretmanin e pranimit deri në shtatë (7) ditë.

8. Aplikimi nga ana e të dënuarit për privilegje dhe avancim në tretmane bëhet përmes formularit përkatës.

9. Për vendosjen në pavijonin e tipit të hapur dhe gjysmë të hapur brenda Institucionit Korrektues nevojitet aprovimi nga Drejtori i IK.

Neni 8

Ekipi Multiprofesional i Institucionit Korrektues

1. Vendimet rreth tretmaneve adekuate duhet të arrihen në mënyrë të drejtë dhe të paanshme dhe duhet të bazohen në sjelljen e të dënuarit, krahas sjelljes përformanca në punë apo arritja e objektivave të planifikimit të dënimit duhet të merren në konsiderim me rastin e vlerësimit.
2. Udhëheqësi i Pavijonit në bashkëpunim me zyrtarin për punë sociale, kujdeset për mbledhjen dhe kompletimin e raporteve para çdo shqyrtimi.
3. Ekipi multiprofesional i IK është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha raporteve për vlerësimin e të dënuarit dhe merr vendim për vendosjen e tij në tretmanin përkatës.
4. Ekipi Multiprofesional i IK përbëhet nga: Zëvendës Drejtori i IK në cilësinë e kryesuesit të ekipit, Udhëheqësi për Programe dhe Tretmane, Udhëheqësi për Siguri, Udhëheqësi i Pavijonit, Zyrtari Social, sipas nevojës Zyrtari Ligjor dhe zyrtarë tjerë.
5. Vendimi për kalim nga një tretman në tretmanin tjetër merret me shumicë votash sipas formularit përkatës.
6. Nëse kryesuesi i ekipit është kundër vendosjes për kalimin në tretmanin tjetër, rasti kalon tek Drejtori i IK për vendosje.

Neni 9

Llojet e tretmaneve

1. Shërbimi Korrektues i Kosovës me qëllim të risocializimit dhe rehabilitimit të të dënuarve zbaton katër (4) nivele të tretmaneve që janë:
 - 1.1 Tretmani i Pranimit;
 - 1.2 Tretmani Themelor;
 - 1.3 Tretmani Standard;
 - 1.4 Tretmani i Avancuar.

Neni 10

Tretmani i pranimit

1. Në parim të gjithë të dënuarit duhet të pranohen në Instituconin Korrektues ku është e vendosur Njësia për Vlerësim dhe Klasifikimin e të dënuarve në të cilin IK të dënuarit do të qëndrojnë në periudhën minimum 7 deri në 21 ditë që konsiderohet si periudhë në tretmanin e pranimit.
2. Pas vlerësimit nga njësia përkatëse, të dënuarit i bëhet planifikimi i dënimit dhe përcaktohet institucioni se ku duhet të ekzekutohet plani i dënimit.
3. Me rastin e transferit dhe pranimit të të dënuarit në Institucionin tjetër Korrektues i dënuari vendoset në tretmanin e pranimit të IK ku do të qëndroj maksimum deri në 7 ditë ku gjatë qëndrimit do ti bëhet një vlerësim nga ekipi profesional i Institucionit Korrektues për tu njoftuar

me planifikimin e dënimit, me qëllim të përcaktimit të vendosjes dhe klasifikimit të tij në pavijonin dhe tretmanin e nevojshëm.

4. Në raste tjera kur pranimi bëhet drejtpërdrejt në Institucione tjera Korrektuese për arsye të sigurisë apo ndonjë arsyeje tjetër i dënuari vendoset në tretmanin e pranimi të IK ku për këtë rast menjëherë duhet të njoftohet Njësia për Vlerësimin dhe Klasifikimin e të Burgosurve e cila do të bëjë vlerësimin përmes mekanizmave të saj për periudhën deri në 28 ditë ku në bazë të raporteve dhe intervistave përcakton vendosjen e të dënuarve në tretmanin tjetër adekuat.

5. Gjatë qëndrimit në tretmanin e pranimi të gjithë të dënuarit do të informohen për rregullat e parapara me rendin shtëpiak në IK.

6. Si rregull të dënuarit pas tretmanit të pranimi kalojnë në tretman standart, përpos në rastet kur ekipi profesional vlerëson se i dënuari mund të vendoset në tretmanin e avancuar.

7. Në rastet kur nuk ka progres i dënuari vazhdon qëndrimin në tretmanin e pranimi edhe për një periudhë tjetër të përcaktuar ose për shkak të sjelljeve jo të mira i dënuari vendoset në tretmanin themelorë.

8. Procedura e kalimit nga tretmani i pranimi në tretmanin themelorë apo standart, përkatësisht qëndrimin të dënuarit në tretmanin e pranimi bëhet me propozim të udhëheqësit ose zyrtarit përgjegjës të pavijonit të pranimi dhe me aprovim të udhëheqësit ose zyrtarit përgjegjës për tretmane.

9. Procedura për kalim nga tretmani i pranimi apo standart në tretmanin e avancuar bëhet me propozim të zyrtarëve përgjegjës të tretmaneve paraprake me aprovim të ekipit multiprofesional për të dënuarit të cilët kanë dënim deri në 3 vite ose mbetje të dënimit deri në 3 vite kjo procedurë në këtë rast konsiderohet procedurë e përsheptuar dhe aplikohet pas kalimit të periudhës vlerësuese prej 7 deri në 14 ditësh.

Neni 11

Të drejtat dhe privilegjet e të dënuarve në tretmanin e pranimi

1. Të drejtat dhe privilegjet e të dënuarve në tretmanin e pranimi:

1.1 Vizitë familjare dy (2) herë në muaj nga një (1) orë;

1.2 Dy (2) telefonata në javë deri në 15 min.;

1.3 Drejtori i IK ose i autorizuari i tij mund të aprovoj telefonata shtesë për raste specifike familjare;

1.4 Bletje nga kantina në vlerë deri në 50 € në javë;

1.5 Shëtitje dy (2) herë nga një (1) orë gjatë ditës;

1.6 Radio (nëse i dënuari e ka një të tillë);

1.7 TV në dhomë, nese nuk është e mundur të sigurohet nga institucioni mund të blihet përmes kantinës.

1.8 Aktivitetet sportive dhe rekreative brenda rrethojës së pavijonit sipas rutinës;

1.9 Punësimi mund të bëhet vetëm brenda rrethojës së pavijonit;

- 1.10 E drejta në shtyp ditorë, libra, rite fetare, korrespondencë;
- 1.11 Lojërat mbështetëse janë të lejuara (shah, njeri mos u hidhëro, letra, domino);
- 1.12 Vizitat në lokale të veçanta një (1) herë në tre (3) muaj;
- 1.13 Gjësende tjera personale të parapara me rendin shtëpiak.

Neni 12

Tretmani themelorë

1. Ky tretman jep të drejtat minimale sipas ligjit, standarteve dhe rregullave ndërkombëtare. Gjatë qëndrimit në këtë tretman të burgosurit duhet të jenë të mbyllur në dhomat e tyre dhe është për ata të dënuar:

- 1.1 Të cilët ulen nga tretmani standart për shkak të sjelljes së tyre jo të mirë;
- 1.2 Nga tretmani i pranimit pasi kanë treguar sjellje jo të mirë;
- 1.3 Për të dënuarit që vijnë për shkak të ndarjes apo veçimit për shkaqe sigurie;
- 1.4 Të dënuarit të cilët vijnë pas përfundimit të masës disiplinore për shkelje të rendë;
- 1.5 Nuk dëshirojnë të punojnë apo refuzojnë punën;
- 1.6 Të dënuarit ndaj të cilëve është duke u zhvilluar procedura disiplinore.

2. Të dënuarit që vendosen në këtë tretman duhet të vlerësohen brenda njëzet e tetë (28) ditësh dhe të informohen për hapat konkret çka pritet prej tyre për t'u kthyer në tretman standart. Kjo duhet të përfshijë objektivat konkret që do t'iu ndihmojë atyre që të përparojnë nga tretmani themelorë. Këta të dënuar përcillen përmes regjistrisë ditorë.

3. Të dënuarit që mbeten në këtë tretman duhet të vlerësohen së paku një (1) herë në muaj nga ekipi vlerësues multiprofesional.

Neni 13

Vazhdimi i tretmanit themelorë

1. Nëse edhe pas periudhës së njëzet e tetë (28) ditëve i dënuari vazhdon sjelljen e tij destruktive (të çrregulluar) ose nuk pajtohet me rregullat përkatëse, tretmani i tij do të vazhdohet edhe për njëzet e tetë (28) ditë të tjera.

2. Pas përfundimit të kësaj periudhe ekipi profesional duhet të bëjë një plan veprues përmes të cilit përcjellë sjelljet e të dënuarit gjatë qëndrimit në këtë tretman, në rast se vlerësohet se i dënuari nuk ka përmirësim të sjelljeve pas periudhës së përcaktuar rishikohet mundësia për transferim në një IK tjetër.

3. Të drejtat e tretmanit themelorë janë të njëjta me ato të tretmanit të pranimit.

Neni 14

Tretmani standart

1. Në tretmanin standart do të vendosen ata të dënuar që vijnë nga tretmani i pranimi apo tretmani themelorë.
2. Për të kaluar nga tretmani i pranimi apo themelorë në tretmanin standart personi i dënuar duhet të ketë aprovimin nga udhëheqësi apo zyrtari përgjegjës për tretmanë.
3. Tretmani standart përfshin të gjithë ata të dënuar që:
 - 3.1 Bashkëpunojnë në realizimin e planit individual të dënimit
 - 3.2 Mbajnë qetësinë, pastërtinë dhe higjienën personale në nivelin e pranueshëm;
 - 3.3 Marrin pjesë në aktivitete sipas rutinës së përcaktuar .
 - 3.3 Respektojnë rendin dhe disiplinën;
 - 3.4 Demostrojnë dhe shfaqin sjellje të mira me stafin dhe të dënuarit e tjerë;
 - 3.5 Marrin pjesë në punë (nëse është e mundur).
- 4 Si rregull të dënuarit në tretmanin standart mund të aplikojnë që të ngriten në tretmanin e avancuar pas tre (3) muajve të qëndrimit në tretmanin standart, në rast refuzimi mund të aplikojnë pas çdo tre (3) muaj.
- 5 Përjashtimisht të dënuarit të cilët kanë dënim deri në 3 vite ose mbetje të dënimit deri në 3 vite mund të kalojnë në tretmanin e avancuar në procedurë të përshpejtuar pas kalimit të periudhës vlerësuese prej 7 deri në 14 ditë.
- 6 Për të dënuarit që kthehen në tretmanin themelorë për shkak të masave të rënda disiplinore aplikimi për ngritje përsëri në tretmanin e avancuar bëhet gjashtë (6) muaj pas përfundimit të masës disiplinore.

Neni 15

Të drejtat dhe privilegjet në tretmanin standart

1. Të drejtat dhe privilegjet në tretmanin standart janë:
 - 1.1 Vizitë familjare dy 2 herë nga një (1) orë në muaj, plus një (1) ekstra vizitë një (1) orëshe, brenda tre (3) muajve me aprovim të drejtorit të IK apo të autorizuarit të tij;
 - 1.2 Dy (2) telefonata në javë;
 - 1.3 Komunikim virtual në rast se nuk ka mundësi të realizohet vizita familjare apo telefonata me aprovim të Drejtorit të IK
 - 1.4 Drejtori i IK ose i autorizuarit i tij mund të aprovoj telefonata shtesë për raste specifike familjare;
 - 1.5 Blerja nga kantina në vlerë deri në 60 € në javë;
 - 1.6 Dy shëtitje nga një (1) orë në ditë;
 - 1.7 TV në dhomë, radio, pajisje shtesë për dëgjimin e muzikës pa mundësi incizimi;
 - 1.8 Aktivitete sportive në sallë dhe fusha sportive;

- 1.9 Punësim brenda dhe jashtë pavijonit;
- 1.10 E drejta në shtyp ditorë, tekste mësimore, libra, korrespondenca, ritet fetare;
- 1.11 E drejta në edukim dhe trajnime profesionale;
- 1.12 Lojra mbështetëse (shah, njeri mos u hidhëro, letra, domino);
- 1.13 Vizitat në lokale të veçanta një (1) herë në tre (3) muaj;
- 1.14 Gjësende tjera personale të parapara me rendin shtëpiak.

Neni 16

Tretmani i avansuar

1. Të dënuarit sjellja e të cilëve është vlerësuar vazhdimisht e mirë, janë aktiv në zbatimin e planifikimit të dënimit, respektojnë rendin dhe disiplinën e IK mund të propozohen për avancim/kalim në tretmanin e avancuar.
2. Për të kaluar në tretmanin e avansuar personi i dënuar duhet të marrë aprovimin nga ekipi multiprofesional i IK.
3. Kriteret që kërkohen për të kaluar në këtë tretman janë:
 - 3.1 I përmbahet planifikimit të dënimit;
 - 3.2 Të ketë dënimin e plotëfuqishëm;
 - 3.2 Të respektojë rendin dhe disiplinën e IK;
 - 3.3 Të demostrojë sjellje të mira me stafin dhe të dënuarit e tjerë;
 - 3.4 Tregon gatishmëri për punë;
 - 3.6 Të mos i jetë shqiptuar ndonjë masë e rëndë disiplinore brenda gjashtë (6) muajve të fundit;
 - 3.7 Të mos ketë qenë i pushuar nga puna brenda gjashtë (6) muajve të fundit me fajin e tij;
 - 3.8 Në asnjë mënyrë nuk duhet të jetë i përfshirë në ndonjë protestë apo të refuzoj urdhërat e stafit;
 - 3.9 Të mos jenë të kategorizuar me rrezikshmëri të lartë dhe shumë të lartë.
4. Personat e dënuar të cilët plotësojnë kriteret e mëposhtme do të kalojnë në procedurë të shkurtër (7 deri në 14 ditë nga tretmanet paraprake) në tretman të avansuar nëse:
 - 4.1 Vijnë vullnetar në vuajtje të dënimit;
 - 4.2 Kohëzgjatja e dënimit të jetë jo më shumë se tre (3) vite apo mbetja nuk i kalon tre (3) vite;
 - 4.3 Nuk është recidivist;
 - 4.4 Niveli i rrezikshmërisë është i ulët.
5. Gjithashtu i dënuari mund të vendoset në tretmanin e avansuar me rastin e ardhjes nga ndonjë IK tjetër që ka qenë në tretmanin e avansuar pas aprovimit nga udhëheqësi apo zyrtari përgjegjës për tretmane brenda periudhës shtatë (7) ditore.
6. Zyrtaret përgjegjës obligohen të kompletojnë raportet e nevojshme dhe ti paraqesin për shqyrtim të ekipi multiprofesional i cili merr vendim për aprovim apo refuzim. Përfundimisht pikës pesë (5) të këtij neni kur aprovimi merret nga udhëheqësi apo zyrtari përgjegjës për tretmane.

Neni 17

Të drejtat dhe privilegjet në tretmanin e avansuar

1. Të drejtat dhe privilegjet në tretmanin e avansuar janë:
 - 1.1 Vizitë familjare dy (2) herë nga një (1) orë në muaj plus një (1) ekstra vizite një (1) orëshe brenda një (1) muaji me aprovim të drejtorit të IK apo të autorizuarit të tij;
 - 1.2 Katër (4) telefonata në javë;
 - 1.3 Komunikim virtual ne rast se nuk ka mundesi te relizohet vizita familjare apo telefonata me aprovim te Drejtorit të IK
 - 1.4 Drejtori i IK ose i autorizuari i tij mund të aprovoj telefonata shtesë për raste specifike familjare;
 - 1.5 Blerje nga kantina në vlerë deri në 70 € në javë;
 - 1.6 Dy shëtitje nga një (1) orë në ditë;
 - 1.7 TV në dhomë me DVD/Video, pajisje shtesë për dëgjimin e muzikës pa mundësi inçizimi.
 - 1.8 Aktivitetet sportive në sallë dhe fusha sportive;
 - 1.9 Mundësi që të punojë jashtë perimetrit të banimit nën mbikëqyrje;
 - 1.10 E drejta në shtyp ditorë, tekste mësimore, libra korrespondenca, ritet fetare;
 - 1.11 E drejta në edukim dhe trajnime profesionale;
 - 1.12 Lojra mbështetëse (shah, njeri mos u hidhëro, letra, domino);
 - 1.13 Mundësi për vizita në lokale të veçanta më së shumti dy (2) herë në tre (3) muaj;
 - 1.14 Mundësi për pushim jashtë IK;
 - 1.15 Gjësende tjera personale të parapara me rendin shtëpiak.

Neni 18

Vendosja e të dënuarve në tipin gjysëm të hapur

1. Të dënuarit të cilët janë të pranueshëm për t'u vendosur në tipin gjysëm të hapur janë të dënuarit e tretmanit të avansuar.
2. Brenda Institucionit Korrektues, të dënuarit mund të vendosen në njësi gjysmë të hapura.
3. Kriteret për kalim në njësin e tipit gjysëm të hapur janë:
 - 3.1 Bashkëpunimi në realizimin e planit individual të dënimit;
 - 3.2 Të ketë dënimin e plotëfuqishëm;
 - 3.3 Të mos ketë vepra tjera penale në pritje;
 - 3.4 Të mos ketë ndëshkime disiplinore gjatë periudhës së kaluar gjashtë (6) mujore;
 - 3.5 Të jetë në gjendje të mirë mentale dhe fizike;
 - 3.6 Të jetë çdo herë i gatshëm për punë;
 - 3.7 Pjesa e mbetur e dënimit të tyre të mos kaloj katër (4) vite;
 - 3.8 Të respektojë rendin shtëpiak dhe rregullat e IK;
 - 3.9 Të demostrojë sjellje të mira me stafin dhe të dënuarit e tjerë.

4. Përjashtimisht pikës 3.7 të këtij neni të dënuarit me dënim më të gjatë se katër (4) vite të cilët janë shfrytëzues të rregullt të pushimit jashtë IK mund të kalojnë në tipin gjysëm të hapur nëse kanë shfrytëzuar rregullisht të paktën tre (3) vikende dhe nuk kanë asnjë masë disiplinore per shkelje te rende në dy (2) vitet e fundit.

5. Të dënuarit të cilët kanë dënim jo më të gjatë se një (1) vit ose mbetja e dënimit të tyre nuk kalon një (1) vit, mund të kalojnë në tipin gjysmë të hapur në procedurë të shpejtuar pasi që të jetë bërë vlerësimi i tyre nga ekipi multiprofesional i IK përmes formularit përkatës pas shtatë (7) ditë nga data e pranimit.

6. Llogaritja e dënimit do të bëhetë sipas lirit normal të dënimit.

7. Për vendosje në tipin gjysmë të hapur nevojitet aprovimi i drejtorit të Institucionit Korrektues.

Neni 19

Të drejtat dhe privilegjet në tipin gjysmë të hapur

1. Të drejtat dhe privilegjet në tipin gjysmë të hapur janë:

1.1 Vizitë familjare katër (4) herë nga një (1) orë në muaj (1 vizitë në javë);

1.2 Telefonatat e pakufizuara (sipas orarit të caktuar);

1.3 Komunikim virtual ne rast se nuk ka mundesi te relizohet vizita familjare apo telefonata me aprovim te Drejtorit të IK

1.4 Blerja nga kantina në vlerë deri në 80 € në javë;

1.5 Dy shëtitje nga një (1) orë në ditë;

1.6 TV në dhomë me DVD/Video, radio, pajisje shtesë për dëgjimin e muzikës pa mundësi inçizimi;

1.7 Aktivitetet kulturore, sportive në sallë dhe fusha sportive sipas orarit të përcaktuar me rutinën ditore të IK;

1.8 Mundësi që të punojë brenda perimetrit të IK pa mbikëqyrje;

1.9 Qasja në shtypin ditorë, libra, korrospodenca dhe ritet fetare;

1.10 E drejta në edukim dhe trajnime profesionale;

1.11 Lojëra mbështetëse (shah, njeri mos u hidhëro, letra, domino);

1.12 Mundësi për beneficion pushim jashtë IK;

1.13 Të drejtat tjera të përcaktuara me rendin shtëpiak.

Neni 20

Vendosja në njësinë e tipit të hapur

1. Të dënuarit që punojnë apo marrin pjesë në programe dhe aktivitete tjera rehabilituese, janë në tretmanin e avancuar mund të vendosen në njësinë e tipit të hapur.

2. Në njësinë e tipit të hapur vendosen të dënuarit që plotësojnë kriteret si në vijim:

- 2.1 Të dënuarit të cilët kanë dënim deri në tri (3) vite, apo që mbetja e dënimit nuk i kalon 3 vite;
 - 2.2 Të kenë rekomandimin e ekipit multiprofesional dhe vendimin e drejtorit të IK;
 - 2.3 Të ketë gjendje të mirë mentale dhe fizike;
 - 2.4 Të ketë së paku tre (3) muaj qëndrim në njësinë e tipit gjysmë të hapur në IK ku aplikohet tipi gjysmë i hapur.
3. Përbashimisht paragrafit 2, nën paragrafit 2.1 të këtij neni të dënuarit me dënim më të gjatë se tre (3) vite por jo më shumë se dhjetë (10) vite mbetje të dënimit mund të vendosen në njësinë e tipit të hapur në IK nëse kanë treguar:
- 3.1 Sjellje të mirë gjatë qëndrimit në IK;
 - 3.2 Pjesëmarrje aktive në programet e parapara për ta;
 - 3.3 Janë shfrytëzues të rregullt të pushimit jashtë IK, së paku tre (3) pushime;
 - 3.4 Të mos kenë asnjë masë disiplinore për shkelje të rëndë gjatë dy (2) viteve të fundit;
 - 3.5 Vlerësimin se niveli i rrezikshmërisë është i ultë.
4. Para se të vendoset i dënuari në njësinë e tipit të hapur i bëhet një vlerësim i rrezikshmërisë nga ekipi multiprofesional i IK se a është i përshtatshëm për njësinë. Interes i veçantë i kushtohet rrezikshmërisë së të dënuarit ndaj komunitetit dhe a paraqet rrezik për arratisje.
5. Vendimin përfundimtar për vendosjen e të dënuarit në njësinë të tipit të hapur e merr drejtori i IK me rekomandim të ekipit multiprofesional.

Neni 21

Të drejtat dhe privilegjet në njësinë e tipit të hapur

1. Të drejtat dhe privilegjet në tretmanin e tipit të hapur janë:
 - 1.1 Vizita familjare deri në tetë (8) herë në muaj nga një (1) orë;
 - 1.2 Telefonatat e pakufizuara sipas orarit të përcaktuar;
 - 1.3 Blerje nga kantina në vlerë deri në 80 € në javë;
 - 1.4 Shëtitje sipas rutinës, së paku dy (2) shëtitje nga një (1) orë në ditë;
 - 1.5 TV në dhomë me DVD/Video, pajisje shtese për dëgjimin e muzikës pa mundësi inçizimi;
 - 1.6 Aktivitetet sportive në sallë dhe fusha sportive;
 - 1.7 Mundësi që të punojë jashtë perimetrit të IK pa mbikëqyrje;
 - 1.8 Qasje në shtyp ditorë, tekste mësimore, libra;
 - 1.9 E drejta në edukim dhe trajnime profesionale;
 - 1.10 E drejta në komunikim elektronik (Skype);
 - 1.11 Lojëra mbështetëse (shah, njeri mos u hidhëro, letra, domino);
 - 1.12 Mundësi për pushim jashtë IK ;
 - 1.13 Mundësi të punësimit jashtë IK;
 - 1.14 Mund të përgatitin vetë ushqimin;
 - 1.15 Mund t'i veshin rrobat e veta personale;

1.16 Gjësende tjera të parapara me rendin shtëpiak.

Neni 22

Vendosja në institucionin e tipit të hapur

1. Të dënuarit që punojnë apo marrin pjesë në programe dhe aktivitete tjera rehabilituese, të cilët janë vlerësuar se janë të përshtatshëm mund të transferohen në institucionin e tipit të hapur.
2. Në Institucionet Korrektuese të tipit të hapur mund të vendosen të dënuarit të cilët i plotësojnë kriteret si në vijim:
 - 2.1 Të dënuarit të cilët kanë dënim deri në tre (3) vite apo mbetje të dënimit më pak se tre (3) vite.
 - 2.2 Të dënuarit e tretmanit të avancuar;
 - 2.3 Të mos këtë vepër tjetër penale në pritje për tu ekzekutuar apo mos te jete duke u zhvilluar procedurë tjetër penale;
 - 2.4 Rekomandimin pozitiv nga ekipi multiprofesional dhe drejtorit të IK.
3. Përgjashtimisht paragrafit 2, nënparagrafit 2.1 të këtij neni të dënuarit me dënim më të gjatë se tre (3) vite por jo më shumë se 10 vite mbetje të dënimit mund të transferohen në IK të tipit të hapur nëse plotësojnë kriteret shtesë si në vijim:
 - 3.1 Sjellja e tyre është vlerësuar shumë e mirë gjatë qëndrimit në IK;
 - 3.2 Pjesëmarrje aktive në programet e parapara për ta;
 - 3.3 Janë shfrytëzues të rregullt të pushimit jashtë IK të paktën 3 vikende;
 - 3.4 Të mos kenë asnjë masë disiplinore për shkelje të rëndë gjatë dy (2) viteve të fundit;
 - 3.5 Vlerësimin se niveli i rrezikshmërisë është i ultë.
4. Para se të transferohet i dënuari në IK-në e tipit të hapur i bëhet një vlerësim i rrezikshmërisë nga ekipi multiprofesional i IK-së se a është i përshtatshëm për IK të tipit të hapur.
5. Vendimi përfundimtar për transferin e të dënuarit në IK të tipit të hapur e merr Drejtori i Përgjithshëm i SHKK-së me rekomandim të drejtorit të IK ose njësisë për vlerësim.
6. Në rast kur të dënuarit pranohen drejtpërdrejt në IK të tipit të hapur sipas urdhëreses së gjzkatës së pari duhet të vendosen në pavijonin e pranimit deri në vlerësimin dhe rekomandimin nga ekipi profesional.

Neni 23

Transferi i të dënuarve nga Njësia për Vlerësim dhe Klasifikim të Burgosurve në IK të tipit të hapur

1. I dënuari mund të transferohet drejtpërdrejt në IK të tipit të hapur pasi që është vlerësuar se janë plotësuar kriteret si në vijim:

- 1.1 Të dënuarit të cilët kanë dënim deri në tre (3) vite apo mbetje të dënimit më pak se tre (3) vite;
 - 1.2 Të mos këtë vepër tjetër penale në pritje për tu ekzekutuar;
 - 1.3 Niveli i rrezikshmërisë të jetë i ulët;
 - 1.4 Vlerësimin pozitiv nga NJVKB;
2. Vendimin për transfer e merr Drejtori i Përgjithshëm i SHKK-së.

Neni 24

Kategoritë specifike për të dënuar

1. Të burgosurit të cilët janë të kategorizuar me rrezikshmëri shumë të lartë të drejtat dhe beneficionet i realizojnë sipas tretmanit themelorë apo standard në bazë të sjelljes. Në momentin e uljës së kategorisë fillon procedura për kalim në tretmanin tjetër;
2. Të burgosurit të cilët janë të kategorizuar me rrezikshmëri të lartë të drejtat dhe beneficionet i realizojnë sipas tretmanit standart. Në momentin e uljës së kategorisë fillon procedura për kalim në tretmanin tjetër.

Neni 25

Qendrimi i të burgosurit në vetmi

1. I dënuari ndaj të cilit është shqiptuar masa disiplinore e vetmisë, gjatë kohës së qëndrimit në vetmi i gëzon të drejtat minimale të parapara me dispozitat ligjore në fuqi;
2. Në momentin e përfundimit të masës së vetmisë i dënuari vendoset në tretmanin themelor dhe në bazë të tretmanit i gëzon të drejtat dhe beneficionet e parapara.

Neni 26

Qendrimi për gratë shtatzëna dhe nënat me fëmijë

1. Gratë e dënuara shtatzëna apo nënat me fëmijë të cilat janë të vendosura në institucionin e veçantë për nënat me fëmijë vazhdojnë trajtimin në tretmanin e njejtë në të cilin kanë qenë para se të vendosen në këtë institucion, ngritja apo ulja në tretman bëhet sipas procedurave të parapara me këtë rregulle.
2. Drejtori i IK mund ti jap beneficione shtesë sipas dispozitave ligjore në fuqi.
3. Dispozitat e këtij neni zbatohen pershtatshëmrisht për gratë shtatzëna dhe nënat me fëmijë të cilat kanë statusin e të paraburgosurave.

Neni 27

Tretmani për të paraburgosurit

Tretmani për të paraburgosurit zbatohet përshtatshëm me tretmanët e të dënuarve deri në nivelin e lejuar si dhe me udhëzimin administrativ për rendin shtëpiak.

Neni 28

Tretmani për të miturit

Tretmanet për të miturit zbatohen sipas akteve nënligjore për të mitur.

Neni 29

Aktivitetet e tretmaneve

1. Aktivitetet e tretmaneve mund të përfshijnë por nuk kufizohen vetëm në:

- 1.1 Shkollimin;
- 1.2 Trajnimet profesionale;
- 1.3 Punën dhe terapitë okupuese;
- 1.4 Seanca grupore me karakter social;
- 1.5 Programe rehabilituese;
- 1.6 Edukimi fizik dhe sporti;
- 1.7 Edukimi terciar dhe vazhdues;
- 1.8 Aktivitetet e lira kreative dhe hobitë;
- 1.9 Përgatitja për lirim dhe i përkujdesjes pas lirim.

2. Tretmanet dhe programet janë të ndërlidhura dhe mbështesin njëra tjetrën.

3. Këto aktivitete duhet të përpiqen të plotësojnë nevojat individuale të të dënuarve në pajtim me planin e dënimit.

4. Qëllimi i të gjitha programeve duhet të jetë riintegrimi i suksesshëm i personave të dënuar në shoqëri. Për të ndihmuar në këtë pjesëmarrje e institucioneve publike dhe private duhet të inkurajohet. Grupet do të inkurajohen të ndihmojnë të dënuarit në rehabilitimin e tyre posaçërisht lidhur me familjen dhe punësimin.

Neni 30

Shkollimi

1. Personi i dënuar ka të drejtë në shkollim fillor dhe të mesëm në pajtim me ligjin për arsimin fillor dhe të mesëm, përderisa për personat e dënuar analfabet organizohen kurse të posaçme.

2. Përmes programeve të veçanta drejtori i Institucionit Korrektues i mundëson personit të dënuar vijimin e shkollimit universitar apo ndonjë shkollim tjetër. Shpenzimet e shkollimit të tillë i mbulon personi i dënuar.

Neni 31

Puna

1. Puna ne IK duhet të konsiderohet si element pozitiv i tretmanit të Institucionit Korrektues dhe kurrë nuk duhet të përdoret si formë e dënimit disiplinor.
2. Institucioni nëse është e mundur duhet të siguroj punë personit të dënuar.
3. Puna e personit të dënuar duhet të shpërblehet.
4. Kur të dënuarit marrin pjesë në aktivitetet gjatë orarit të punës ata duhet shpërblyer në të njëjtën mënyrë sikur të kishin punuar.
5. Të dënuarit duhet të marrin sigurim adekuat social ngjashëm me atë që jepet në shoqërinë e lirë.
6. Nga i mituri nuk pritët dhe as nuk kërkohet të punojë gjatë kohës sa është në shkollë.
7. Femrat kanë të drejtë të mos punojnë gjatë shtatzanisë, lehonisë ose për shkak të lindjes në pajtim me parimet e punës.

Neni 32

Aktivitetet religjioze

1. Tretmani i IK duhet të organizohet për aq sa është e mundshme që të dënuarit ta ushtrojnë praktikimin e religjionit të tyre, të marrin pjesë në shërbimet religjioze, takimet e lutjeve dhe ngjarjet tjera religjioze të udhëhequra nga përfaqësuesit e tyre të aprovuar të atij religjioni apo besimi, të pranojnë vizita private nga përfaqësuesit e tillë dhe të kenë në posedim të tyre libra apo literaturë në lidhje me religjionin apo besimin e tyre.

Neni 33

Ulja (degradimi) nga tretmani

1. Ulja e tretmanit nuk konsiderohet dënim disiplinor.
2. Nëse sjellja e të dënuarit apo mungesa e progresit tregon se ai nuk mund ta mbaje nivelin e vet momental të tretmanit, ai mund të degradohet në një nivel më poshtë (si masë administrative, jo si dënim i shqiptuar me vendim). Një degradim i madh i të dënuarit si p.sh nga tretmani i avancuar në themelorë duhet shmangur përveç rasteve kur ka shkelje të rënda disiplinore. Në këto raste vendimet i merr drejtori i Institucionit Korrektues.

3. Sistemi disiplinor dhe ai i tretmaneve-përfitimit të privilegjeve janë dy sisteme të ndara. Nivelet e tretmaneve determinohen në bazë të sjelljes.
4. Humbja e privilegjit të caktuar si pasojë e dënimit disiplinor për shkelje të lehtë, apo që është në dikrecion të mbikëqyrësit të lartë nuk duhet të rezultojë automatikisht në humbjen e tretmanit.
5. Çdo herë kur i dënuari nuk i respekton rregullat e institucionit dhe të tretmanit në të cilin gjendet, zyrtari korrektues i cili përcjellë të dënuarin ka për obligim të njoftojë mbikëqyrësin-mbikëqyrësin e lartë. Mbikëqyrësi i Lartë ka për obligim të bisedojë me të dënuarin me qëllim të këshillimit dhe ta njoftojë se do të jetë nën përcjellje për dhjetë (10) ditët e ardhshme për t'a përmirësuar sjelljen dhe performancën. Për sjelljen e të dënuarit në baza ditore njoftohet edhe Udhëheqësi i Pavijonit.
6. Degradimi nga tretmani standart në tretmanin themelorë bëhet në rastet si në vijim:
 - 6.1 Nëse i dënuari dështon në përmbushjen e kritereve të përcaktuara në tretmanin standart;
 - 6.2 Tri vërejtje me shkrim brenda periudhës tre (3) mujore;
 - 6.3 Shpallet fajtor për shkelje të rëndë disiplinore;
 - 6.4 Refuzon të punoj apo të marrë pjesë aktive në planifikimin e dënimit.
 - 6.5 Për uljen në tretman inicohet me propozim të udhëheqësi të pavijonit apo zyrtari përgjegjës për tretmane. Ekipi profesional merr vendim për degradim.
7. Degradimi nga tretmani i avancuar në atë standart, personi i dënuar do të ulet në tretman standart nëse:
 - 7.1 Gjendet fajtor në ndonjë shkelje të rëndë disiplinore apo 3 shkelje të lehta disiplinore brenda periudhës 6 mujore;
 - 7.2 Dështimi i përmbushjes së kritereve të tretmanit të avancuar;
 - 7.3 Refuzon të punoj apo të marrë pjesë aktive në planin e planifikimit të dënimit;
 - 7.4 Me këtë rast bëhet propozimi mha udhëheqësi i pavijonit apo zyrtari përgjegjës për tretmane për uljen e tretmanit. Ekipi profesional merr vendim për degradim.
8. Të dënuarit duhet të informohen dhe mund të ju ipet 1 kopje për të gjitha vendimet që janë marrë ndaj tyre e që kanë rezultuar me ulje në tretman si dhe të ju ipet mundësia për ankesë ndaj vendimit.
9. Secili vendim për ulje në tretman duhet të vendosen në dosjen e të dënuarit.

Neni 34

Dispozitat shfuqizuese/kalimtare

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulle shfuqizohet rregulla tretmane për të dënuar nr.3127 datë: 19.09.2019. Nëse ndonjë nga dispozitat e kësaj rregulle është në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe udhëzimet administrative në fuqi vlejnë dispozitat ligjore dhe aktet nënligjore.

Neni 35

Hyrja në fuqi

Kjo rregullë e brendshme hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Dhjetor 2022

Sami Gashi

Zëvendësues Drejtor i Përgjithshëm
Shërbimi Korrektues i Kosovës

